SEKSIONI I KATËRT

ÇËSHTJA DELIJORGJI KUNDËR SHQIPËRISË

(ankimi nr. 6858/11)

VENDIM
STRASBURG
28 prill 2015

I FORMËS SË PRERË
14.9.2015

Ky vendim është bërë i formës së prerë sipas nenit 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Delijorgji kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), në gjykimin si Dhomë e përbërë nga:
Päivi Hirvelä, *president,*
George Nicolaou,
Ledi Bianku,
Nona Tsotsoria,
Paul Mahoney,
Krzysztof Woktyczek,
Faris Vehabović, *gjykatës,*
dhe Fatoş Aracı, *zëvendësregjistrues i Seksionit*,
pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 31 mars 2015,
shpall vendimin e mëposhtëm të miratuar në atë datë.

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në ankimin (nr. 6858/11) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), nga një shtetas shqiptar, z. Mihal Delijorgji (ankuesi), më 4 janar 2011.

2. Ankuesi u përfaqësua nga znj. E. Kokona dhe z. M. Haxhia, avokatë të cilët e ushtrojnë aktivitetin në Tiranë. Qeveria shqiptare (qeveria) u përfaqësua nga agjentja e saj znj. A. Hicka, Avokatja e Përgjithshme e Shtetit.

3. Ankuesi pretendonte se kishte pasur shkelje të të drejtave të tij sipas nenit 5 § 1 (c) dhe nenit 5 § 4 të Konventës.

4. Më 3 shtator 2013, ankimi iu komunikua Qeverisë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Ankuesi ka lindur në vitin 1966 dhe banon në Tiranë.

A. Ndalimi i ankuesit dhe kërkesat për lirim

6. Më 15 mars 2008, në një objekt demontimi ndodhi një shpërthim masiv. Shpërthimi mori 26 jetë. Dyqind e gjashtëdhjetë e pesë persona të tjerë u plagosën rëndë ose lehtë dhe një sërë ndërtesash që gjendeshin përreth u dëmtuan rëndë. Procesi i demontimit realizohej nga një kompani tregtare private, administrator i së cilës ishte ankuesi.

7. Pas shpërthimit, prokurori nisi procedimet penale kundër ankuesit dhe 28 personave të tjerë.

8. Më 17 mars 2008, ankuesi mbeti në arrest. Gjykata e Rrethit nuk vendosi asnjë limit kohor në lidhje me kohën e ndalimit të tij. Dukej se ai ishte i dyshuar për kryerjen e veprës penale të vrasjes në rrethana

rënduese të më shumë se dy personave, shkatërrimin e pronës me lëndë shpërthyese dhe shkeljen e rregullave për eksplozivët, substancat ndezëse dhe ato radioaktive", në kundërshtim me nenet 79 (dh) dhe (ë), 152 dhe 282 të Kodit Penal.

9. Më 13 mars 2009, prokurori e dërgoi çështjen kundër ankuesit dhe bashkëtëpandehurve të tjerë për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, duke qenë se një nga të bashkëpandehurit ishte Deputet, si edhe Ministër Kabineti.

10. Më 22 maj 2009, Gjykata e Lartë vendosi të ndërpriste procedurat kundër Deputetit, i cili ishte në të njëjtën kohë edhe Ministër Kabineti, nga ato kundër ankuesit dhe të bashkëpandehurve të tjerë.

11. Më 11 qershor 2009, dosja e çështjes kundër të gjithë të bashkëpandehurve, duke përfshirë edhe ankuesin, u regjistrua në Gjykatën e Rrethit Tiranë (Gjykata e Rrethit) për shqyrtim.

1. Kërkesa e parë për lirim

12. Më 19 korrik 2010, ankuesi kërkoi lirimin e tij duke qenë se limitet kohorë të parashikuar në nenet 262 dhe 263 § 2 (c) të Kodit të Procedurës Penale (KPP) kishin përfunduar. Ai argumentoi se afati kohor i përcaktuar kishte nisur që në 13 mars 2009, datë në të cilën çështja ishte çuar për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

13. Më 23 korrik 2010, Gjykata e Rrethit Tiranë, në një vendim bisedor e rrëzoi kërkesën. Ajo argumentoi se duke qenë se afati kohor kishte filluar që prej 11 qershorit 2009, datë në të cilën dosja e çështjes ishte regjistruar në regjistrin e saj, dhe duke qenë se ajo kishte qëndruar ose zgjatur më tej, për shkak të vendimeve të tjera inter-lokutore, afati kohor nuk kishte përfunduar ende.

14. Më 6 gusht 2010, Gjykata e Apelit e la vendimin në fuqi.

15. Më 3 nëntor 2010, Gjykata e Lartë anuloi të dyja vendimet. Ajo arsyetoi se neni 263 i KPP-së parashikonte tri afate: i pari i cili nis nga data e arrestimit të të pandehurit deri në datën kur dosja transferohet në gjykatën e shkallës së parë (neni 263 § 1 i KPP-së); i dyti fillon që nga ky moment deri në datën e dhënies së vendimit nga gjykata (neni 263 § 2 i KPP-së); dhe i treti që nga ky moment deri në datën e dhënies së vendimit nga gjykata e apelit (neni 263 § 3 i KPP-së). Sipas Gjykatës së Lartë, në çështjen e ankuesit, afati i parë kohor përfundoi më 13 mars 2009, kur çështja u dërgua në Gjykatën e Lartë (neni 263 § 1 i KPP-së). Në këtë datë, nisi afati i dytë kohor përpara gjykatës së shkallës së parë (neni 263 § 2 i KPP-së), duke qenë se Gjykata e Lartë po e dëgjonte çështjen si gjykatë e shkallës së parë, ndërsa një nga të bashkëpandehurit ishte deputet dhe Ministër Kabineti. Edhe pse procedimet kundër Deputetit u shkëputën nga ato kundër ankuesit dhe të bashkëpandehurve të tjerë, periudha midis 13 marsit 2009 dhe 11 qershorit 2009, datë në të cilën dosja e çështjes kundër ankuesit u regjistrua në Gjykatën e Rrethit, duhet të merret në konsideratë për shkak të afatit kohor të parashikuar në nenin 263 § 2 të KPP-së. Gjykata e Lartë hodhi mendimin se afati kohor i parashikuar në nenin 265 të KPP-së duhej zbritur nga afati kohor i parashikuar në nenin 263, nëse qëndrimi i ishte atribuar *inter alia*, njërit prej të bashkëpandehurve ose avokatit të tij. Për arsyet e përmendura më sipër, Gjykata e Lartë e ridërgoi çështjen për t'u ridëgjuar nga një trup tjetër gjykues.

Procedimet e ridëgjimit

16. Më 25 nëntor 2010, avokati i ankuesit, mbështetur në vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 3 nëntor 2010, kërkoi, me shkrim, lirimin e ankuesit. Ai argumentoi se periudha e tij e ndalimit përpara procesit gjyqësor ishte zgjatur me 81 ditë.

17. Më 26 nëntor 2010, Gjykata e Rrethit kundërshtoi kërkesën duke argumentuar se nuk ishte dërguar me shkrim në përputhje me ligjin. Ankuesi apeloi.

18. Më 17 dhjetor 2010, Gjykata e Apelit rrëzoi vendimin dhe e ridërgoi çështjen për ridëgjim te një trup gjykues tjetër. Ajo konstatoi se Gjykata e Rrethit nuk kishte përmbushur detyrat e deleguara nga vendimi i Gjykatës së Lartë, i datës 3 nëntor 2010.

19. Ankuesi apeloi me argumentin se Gjykata e Apelit duhej ta kishte shqyrtuar vetë çështjen në vend që të vononte procedimet.

20. Më 27 janar 2011, Gjykata e Lartë e kundërshtoi apelimin.

21. Më 16 shkurt 2011, Gjykata e Rrethit e pushoi gjykimin në bazë të vendimit të saj të datës 7 shkurt 2011 (shiko paragrafin 25 më poshtë).

2. Kërkesa e dytë për lirim

22. Më 6 dhjetor 2010, avokati i ankuesit paraqiti kërkesën e dytë për lirimin e ankuesit bazuar në argumentin se afatet kohore të parashikuara nga nenet 262 dhe 263 § 2 (c) të KPP-së kishin përfunduar.

23. Në po të njëjtën ditë, Gjykata e Rrethit, në një vendim interlokutor, kundërshtoi kërkesën. Ajo vendosi se afati kohor kishte filluar nga 11 qershori 2009, datë në të cilën kjo gjykatë kishte regjistruar dosjen e çështjes. Ajo ishte mbajtur për një periudhë prej 8 muajsh dhe 12 ditësh. Për pasojë, Gjykata e Rrethit pohoi se kishin mbetur 2 muaj dhe 18 ditë nga paraburgimi përpara gjykimit deri në përfundim të afatit kohor prej dymbëdhjetë muajsh, sipas parashikimit të nenit 263 § 2 (c). Për sa i përket përfundimeve të Gjykatës së Lartë, më 3 nëntor 2010, Gjykata e Rrethit deklaroi se ato vareshin nga ridëgjimi i çështjes nga trupi gjykues dhe jo nga dëgjimi në gjykatë i një kërkese të veçantë për lirimin.

3. Kërkesa e tretë për lirim

24. Më 7 shkurt 2011, avokati i ankuesit kërkoi lirimin e ankuesit mbi bazën se afatet kohore të parashikuara nga nenet 262 dhe 263 § 2 (c) të KPP-së kishin përfunduar.

25. Në po të njëjtën ditë, në një vendim interlokutor, Gjykata e Rrethit urdhëroi lirimin e menjëhershëm të ankuesit dhe kalimin e tij në arrest shtëpie në përputhje me nenin 266 § 1 të KPP-së. Nuk u dhanë arsye të mëtejshme. Gjykata e Rrethit u mbështet në vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 2 shkurt 2011, i cili urdhëronte lirimin e një të bashkëpandehuri tjetër i cili ishte ndaluar në po të njëjtën ditë si ankuesi, sepse afatet kohore të paraburgimit përpara procesit gjyqësor, të parashikuara në nenin 263 § 2 (c), kishin përfunduar (shiko paragrafin 31 më poshtë). Ajo pranoi se afati kohor kishte filluar që prej 31 marsit 2009 dhe kishte kaluar përtej periudhës 12-mujore të parashikuar me ligj. Vendimi nuk tregonte datën e mbarimit të afatit kohor. Prokurorët apeluan.

26. Rezultoi se ankuesi u vendos menjëherë në arrest shtëpie.

27. Më 11 mars 2011, pas apelimit të prokurorit, Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit.

28. Më 9 maj 2011, pas apelit të prokurorit, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e gjykatave më të ulëta.

B. Ankesa për lirimin e të bashkëpandehurit

29. Më 24 nëntor 2010, Gjykata e Rrethit kundërshtoi një kërkesë të bashkëpandehurit për lirimin e tij, mbi argumentin se afati kohor për "gjyqin e tij të mbetur pezull" në paraburgim kishte mbaruar. Në interpretim të nenit 263 § 2 (c) të KPP-së, Gjykata e Rrethit argumentoi se afati kohor kishte filluar që prej 11 qershorit 2009, datë kur dosja e çështjes u regjistrua në regjistrin e saj. Më tej, ajo vijoi se vendimi i Gjykatës së Lartë, i datës 3 nëntor 2010, nuk varej nga ai trup gjykues (shiko paragrafin 15 më sipër).

30. Më 17 shtator 2010, Gjykata e Apelit e la vendimin në fuqi.

31. Më 2 shkurt 2011, Gjykata e Lartë njohu apelimin e të bashkëpandehurit kundër vendimeve të gjykatave më të ulëta. Në interpretim të nenit 263 § 2 (c) të KPP-së, Gjykata e Lartë argumentoi se periudha e "gjyqit të mbetur pezull" në paraburgim kishte filluar më 13 mars 2009, kur prokurori e kishte regjistruar çështjen për shqyrtim në atë gjykatë. Kjo e fundit e kishte shqyrtuar atë si gjykatë e shkallës së parë në përputhje me nenin 75 (b) të KPP-së.

32. Më tej, Gjykata e Lartë iu referua vendimit të saj, të datës 3 nëntor 2010, i cili i orientonte gjykatat më të ulëta të llogarisnin periudhën e ndalimit "gjatë procesit gjyqësor", por ishte shpërfillur nga Gjykata e Rrethit në atë grup procedimesh. Gjykata e Lartë urdhëroi kalimin e të bashkëpandehurit në arrest shtëpie.

C. Dënimi i ankuesit

33. Më 12 mars 2012, në një gjykim të gjatë, Gjykata e Rrethit Tiranë e shpalli ankuesin fajtor për "shkeljen e rregullave për substancat eksplozive, të djegshme ose radioaktive" – në kundërshtim me nenin 282 të Kodit Penal, dhe e dënoi atë me 10 vjet burgim. Të gjitha palët apeluan.

34. Më 13 shkurt 2013, Gjykata e Apelit Tiranë e la vendimin në fuqi. Megjithatë, ajo e uli dënimin e ankuesit me një të tretat për shkak të përdorimit procedurës së përmbledhur.

35. Apelimi i ankuesit u hodh poshtë nga Gjykata e Lartë, më 19 korrik 2013.

36. Më 14 shkurt 2013, në një letër për ekzekutimin e dënimit, prokuroria deklaroi se periudha e ndalimit të ankuesit përpara procesit gjyqësor nga data 17 mars 2008 deri më 2 shkurt 2011 duhej të llogaritej si një periudhë burgimi prej katër vitesh dhe katër muajsh në përputhje me ligjin. Kësaj periudhe i duheshin shtuar edhe dy vjet dhe gjashtë ditë, periudhë gjatë së cilës ankuesi kishte qenë në arrest shtëpie. Në total, ankuesi kishte vuajtur gjashtë vjet, katër muaj dhe gjashtë ditë burgim. Për pasojë, pjesa e mbetur e dënimit për t'u vuajtur nga ankuesi ishte tre muaj dhe njëzet e katër ditë burgim.

37. Më 18 mars 2013, Gjykata e Rrethit, duke pasur parasysh sjelljen e mirë të ankuesit e uli dënimin e tij me 70 ditë.

38. Më 19 mars 2013, ankuesi u lirua nga burgu pasi kishte vuajtur pjesën e mbetur të dënimit.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE VENDASE

A. Kushtetuta

39. Pjesa e Kushtetutës në lidhje me çështjen parashikon si më poshtë:

"Neni 131

Gjykata Kushtetuese duhet të vendos për: ... (f) ankesat nga individët për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave."

B. Kodi i Procedurës Penale (KPP)

1. Juridiksioni i Gjykatës së Lartë

40. Neni 75 (b) parashikon se Gjykata e Lartë dëgjon si gjykatë e shkallës së parë çështjet në lidhje me aktet penale të kryera, *inter alia*, nga një Deputet dhe nga një Ministër Kabineti.

2. Masat shtrënguese

41. Sipas KPP-së, masat e sigurimit personal përfshijnë masat shtrënguese dhe masat ndaluese. Masat shtrënguese përfshijnë, *inter alia*, arrestin në shtëpi dhe ndalimin (neni 232). Një masë shtrënguese fillimisht urdhërohet nga një prokuror, për t'u aprovuar më pas me anë të një vendimi gjykate brenda dyzet e tetë orëve (nenet 244 dhe 258). Brenda dhjetë ditëve, i pandehuri, përfa-qësuesi i tij ose prokurori mund të apelojnë ndaj një mase shtrënguese në një gjykatë më të lartë (nenet 249 dhe 259).

3. Ndalimi dhe afatet kohore

a) Tre tipat e ndalimit

42. KPP-ja përcakton tri lloje ndalimesh: i pari "gjatë hetimeve", çka do të thotë ndërsa prokuroria heton çështjen. Kjo periudhë ndalimi shtrihet që nga arrestimi i të pandehurit deri në datën kur dosja transferohet në gjykatën e shkallës së parë (ose "Gjykatën e Rrethit") (neni 263 § 1); i dyti "gjatë procesit gjyqësor", çka do të thotë ndërsa çështja gjykohet nga gjykata e shkallës së parë. Kjo periudhë paraburgimi shtrihet nga data në të cilën dosja e çështjes regjistrohet në gjykatën e shkallës së parë deri në dhënien e vendimit të gjykatës së shkallës së parë (neni 263 § 2); i treti "gjatë apelimit", çka do të thotë ndërsa çështja dëgjohet në apel. Kjo periudhë ndalimi shtrihet nga shpallja e vendimit të gjykatës së shkallës së parë deri në shpalljen e vendimit të gjykatës së apelit (neni 263 § 3). Në rastin e anulimit të një vendimi të formës së prerë nga një gjykatë më e lartë, fillojnë afatet kohore për tipin e ndalimit për të cilin çështja është ridërguar (neni 263 § 4).

b) Afatet kohore për ndalimin "gjatë procesit gjyqësor"

43. Për qëllime të çështjes në fjalë, periudha e ndalimit "gjatë procesit gjyqësor" përfundon nëse që nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë, kalojnë 12 muaj pa u marrë një vendim nga gjykata e shkallës së parë, kur procedurat penale kanë të bëjnë me shkelje të cilat janë të dënueshme që nga burgimi me dhjetë vjet heqje lirie deri në burgim të përjetshëm (neni 262 § 2 (c)).

44. Neni 262 § 1 parashikon se në përfundim të ndalimit, gjykata duhet të urdhërojë lirimin e menjëhershëm të dyshuarit ose të pandehurit. Megjithatë, gjykata mund të vendosë masa të tjera sigurimi për një të pandehur i cili është liruar për shkak të përfundimit të afateve kohore, nëse ekzistojnë ende

arsyet për të cilat është urdhëruar ndalimi përpara procesit gjyqësor (neni 266 § 1).

c) Pezullimi i afateve

45. Neni 265 parashikon pezullimin e afateve kohore për ndalimin e dhënë me vendim gjykate, i cili është i apelueshëm. Pezullimi i afateve kohore ndodh kur shqyrtimi gjyqësor është anuluar ose pezulluar: a) për shkak të veprimeve ose kërkesave të padrejta të pandehurit ose të avokatit të tij; ose b) për shkak të mosparaqitjes ose largimit të avokatit të të akuzuarit (neni 265).

Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 6/2003

46. Më 11 nëntor 2003, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosën se kohëzgjatja e përgjithshme e ndalimit përpara procesit gjyqësor nuk përfshinte periudhën gjatë së cilës ishin pezulluar afatet kohore. Më tej, për sa ka të bëjë me çështjen, sipas Gjykatës së Lartë, pezullimi i afateve kohore duhej të vendosej duke gjykuar mbi sjelljen e të akuzuarit dhe përfaqësuesit të tij dhe jo për shkak të sjelljes së prokurorit apo të gjykatës.

d) Kohëzgjatja e përgjithshme e ndalimit përpara procesit gjyqësor

47. Neni 263 § 6 parashikon se kohëzgjatja e përgjithshme nuk duhet t'i kalojë tre vjet në rastin kur procedurat lidhen me shkelje të cilat janë të dënueshme nga dhjetë vjet heqje lirie deri në burgim të përjetshëm.

4. E drejta për kompensim për ndalim të padrejtë

48. Neni 263 § 6 parashikon se kohëzgjatja e përgjithshme e ndalimit përpara procesit gjyqësor kompensohet nëse, me anë të një vendimi të formës së prerë, vendimi që urdhëronte ndalimin e tij nuk përmbushte kërkesat e parashikuara në KPP. Sipas nenit 269 të KPP-së, kërkesa për kompensim duhet bërë brenda tre vjetëve nga data e vendimit të formës së prerë.

49. Shuma e kompensimit dhe përllogaritja e saj bëhet bazuar në Aktin e Kompensimit për Ndalim të Padrejtë (ligji nr. 9381, i datës 28 prill 2005).

Ligji bazuar në vendimet e gjykatave vendase parashtruar nga qeveria

50. Më 24 mars, 4 nëntor dhe 22 nëntor 2010, Gjykata e Rrethit Tiranë pranoi kërkesën e palës pretenduese për kompensim për burgim të padrejtë që nga momenti i arrestimit të tyre deri sa u liruan (vendimet nr. 2332, 8260 dhe 8841). Në këto çështje dënimi ndaj pretenduesve u pezullua nga Gjykata e Lartë, e cila në vijim vendosi pushimin e procedurave kundër tyre.

LIGJI

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 5 § 1 TË KONVENTËS

51. Bazuar në nenin 5 § 1 të Konventës, ankuesi shfaq pakënaqësinë se ndalimi i tij i pushuar (të paktën që prej 20 korrikut 2010 ose ndryshe që prej 14 gushtit ose 7 tetorit 2010), nuk ishte në përputhje me ligjin. Kjo ankesë duhet shqyrtuar bazuar në nenin 5 § 1 (c) të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

"1. Çdokush ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

...

(c) kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

52. Qeveria parashtroi se në kohën kur ankuesi paraqiti ankimin e tij në Gjykatë, çështja e tij ishte ende pezull në gjykatat vendase. Në këto rrethana, çështja duhej të ishte deklaruar e papranueshme për mosshfrytëzim të mjeteve kompensuese vendase. Gjithashtu, ajo argumentoi se ankuesi nuk kishte paraqitur ndonjë kërkesë kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese. Duke u mbështetur te ligjet bazuar në vendimet e gjykatave vendase, qeveria mbronte bindjen se ankuesi duhej të kishte paraqitur një kërkesë për kompensim për periudhën e pretenduar të ndalimit të padrejtë (shiko paragrafin 50 më sipër).

53. Ankuesi nuk bëri ndonjë koment në veçanti, por mbrojti pretendimin se ankesa e tij ishte e pranueshme.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Paraqitja e një ankimi të parakohshëm

54. Sipas nenit 35 § 1 të Konventës "Gjykata mund të merret me çështjen vetëm pasi të jenë shfrytëzuar të gjitha mjetet kompensuese vendase". Vlerësimi nëse janë shfrytëzuar mjetet kompensuese vendase, normalisht realizohet duke iu referuar datës në të cilën ankesa është paraqitur në Gjykatë (shiko, midis të tjerave, Izet Haxhia kundër Shqipërisë, nr. 34783/06, § 48, 5 nëntor 2013). Megjithatë, ky vendim nuk është as i prerë dhe as në gjendje të zbatohet automatikisht; ai duhet ushtruar me një normë fleksibiliteti dhe pa formalizma të tepërta, duke pasur parasysh kontekstin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (shiko, midis të tjerave, *Akdivar dhe të Tjerët kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, § 69, Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve 1996-IV). Një gjë e tillë nënkupton, gjithashtu, se faza e fundit e përdorimit të mjeteve kompensuse vendase mund të arrihet menjëherë pas dorëzimit të ankesës, por përpara se Gjykata të përcaktojë çështjen e pranueshmërisë (*Karoussiotis kundër Portugalisë,* nr. 23205/08, § 57, GJEDNJ 2011 (ekstrakte)).

55. Në çështjen në fjalë, ankuesi e paraqiti ankimin e tij më 4 janar 2011. Në atë kohë, procedurat vendase në lidhje me kërkesën e ankuesit për lirim, si edhe procedurat kryesore ishin ende pezull. Në kohën kur çështja iu komunikua Qeverisë, më 3 shtator 2013, procedurat në lidhje me kërkesën e ankuesit për lirim kishin përfunduar. Në këto rrethana, Gjykata gjykon se, duke pasur parasysh pranueshmërinë e kësaj ankese, ankimi aktual nuk mund të konsiderohet si i pamatur. Për këtë arsye, Gjykata vendos ta rrëzojë këtë kundërshtim.

b) Mosdorëzimi i një ankese kushtetuese

56. Për sa i përket paraqitjes së një ankese kushtetuese, Gjykata kujton se të vetmet mjete për t'u përdorur sipas nenit 35 § 1 janë ato që kanë të bëjnë me shkeljen e pretenduar dhe që janë të disponueshme dhe të mjaftueshme (shiko *McFarlane kundër Irlandës* [GC], nr. 31333/06, § 107, 10 shtator 2010). Për sa ka të bëjë me Qeverinë, aty ku ajo pretendon mosshfrytëzim, Gjykata duhet të sigurohet se mjeti kompensues ishte i efektshëm në teori dhe në praktikë në kohën e duhur, çka do të thotë, se ai ishte i aksesueshëm, mund të ofronte korrigjim lidhur me pakënaqësitë e ankuesit dhe ofronte mundësi të arsyeshme për sukses (shiko *Scoppola kundër Italisë* (nr. 2) [GC], nr. 10249/03, § 71, 17 shtator 2009).

57. Në vijim, Gjykata ka pranuar kundërshtimin e qeverisë përgjegjëse për mosshfrytëzim të mjeteve vendase, me kusht që mjeti në fjalë të ekzistonte përpara dorëzimit të ankimit dhe që ligjet vendase bazuar në vendimin e gjykatave, të mbështesnin efikasitetin e tij (shiko *Vučković dhe të Tjerët kundër Serbisë*, [GC], nr. 17153/11, §§ 78 dhe 83-84, 25 mars 2014). Anasjellas, kur një mjet kompensues i sugjeruar nga një qeveri përgjegjëse në fakt nuk ofron perspektiva të arsyeshme për sukses, për shembull, duke marrë parasysh ligjin bazuar në vendimin e kësaj Gjykate ose ligjin vendas bazuar në vendimin e gjykatave, fakti se ankuesi nuk e ka përdorur atë, nuk përbën pengesë për pranueshmërinë e ankesës (shiko *Sakhnovskiy kundër Rusisë* [GC], nr. 21272/03, §§ 40-45, 2 nëntor 2010 dhe *Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 42184/05, § 58, GJEDNJ 2010).

58. Megjithatë, në çështjet ku ligji vendas para-shikon në mënyrë eksplicite një mjet kompensues të caktuar, i cili është i arritshëm dhe qartazi jo i kotë, ekzistenca e dyshimeve nga ana e ankuesit në lidhje me perspektivën për sukses nuk është një arsye e vlefshme për të mos shfrytëzuar atë linjë kompensimi (shiko, për shembull, *Milošević kundër Holandës* (vendim), nr. 77631/01, 19 mars 2002; *Vorobyeva kundër Ukrainës* (vendim), nr. 27517/02, 17 dhjetor 2002; dhe *Pellegriti kundër Italisë* (vendim), nr. 77363/01, 26 maj 2005). Në të kundërt, është në interes të ankuesit që t'i adresohet gjykatës së duhur, për t'i dhënë asaj mundësinë nxjerrë të drejtat ekzistuese me anë të fuqisë së saj interpretuese (shiko *Ciupercescu kundër Rumanisë*, nr. 35555/03, § 169, 15 qershor 2010).

59. Duke iu rikthyer çështjes aktuale, neni 131 (f) i Kushtetutës parashikon një mjet kompensues specifikisht për ankesat ndaj shkeljes së "të drejtave kushtetuese për një seancë gjyqësore të paanshme"

(shiko paragrafin 39 më sipër). Bazuar në ligjin sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata vazhdimisht ka pranuar se në parim, një ankesë kushtetuese është një mjet kompensues i efektshëm dhe për këtë arsye kërkohet për t'u shfrytëzuar në lidhje me të drejtën e ankuesit për një seancë gjyqësore të paanshme, sipas nenit 6 të Konventës (shiko *Balliu kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 74727/01, 30 shtator 2004*; Beshiri dhe të Tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 7352/03, 1 dhjetor 2009). Në këto rrethana, qeveria nuk nxori asnjë vendim të Gjykatës Kushtetuese mbështetur në këtë parashikim kushtetues për të vendosur në favor të një apeluesi në një situatë të krahasueshme me atë të ankuesit në lidhje me të drejtën për liri, siç edhe garantohet nga neni 5 i Konventës (shiko, *mutatis mutandis*, *Salah Sheekh kundër Holandës*, nr. 1948/04, §§ 119-27, 11 janar 2007).

60. Më tej, vijohet, se kundërshtimi i Qeverisë për mosshfrytëzim nuk mund të pranohet.

c) Mosdorëzimi i kërkesës për kompensim

61. Gjykata përsërit se e drejta e cilitdo për të mos u privuar nga liria "në përputhje me një procedurë të përshkruar me ligj", nuk është e njëjta si e drejta për t'u kompensuar për ndalim të paligjshëm. Paragrafi 1 i nenit 5 të Konventës mbulon të mëparshmin dhe paragrafin 5 të nenit 5 (shiko, për shembull, *Moskovets kundër Rusisë*, nr. 14370/03, § 51, 23 prill 2009). Kur bëhet fjalë për ligjshmërinë e ndalimit, një akt për dëmet kundër shtetit nuk është një mjet i cili duhet përdorur, sepse e drejta për shqyrtimin e ligjshmërisë së dënimit nga një gjykatë dhe e drejta për kompensim për çdo privim lirie, e papajtueshme me nenin 5, janë dy të drejta të ndryshme (shiko për shembull *Schwabe dhe M.G. kundër Gjermanisë*, nr. 8080/08 dhe 8577/08, § 49, GJEDNJ 2011 (ekstrakte) dhe *Włoch kundër Polonisë*, nr. 27785/95, § 90 GJEDNJ 2000-XI).

62. Duke iu rikthyer çështjes në fjalë, gjykatat vendase nuk njohën dhe as nuk konstatuan ndalimin e paligjshëm të ankuesit. Për këtë arsye, Gjykata shpjegon se një akt për kompensim sipas nenit 268 § 2 të KPP-së nuk do të kishte pasur mundësi për sukses në mungesë të një konkluzioni nga gjykatat vendase për argumentin se vendimi që urdhëronte ndalimin e ankuesit ishte i paligjshëm (shiko paragrafin 48 më sipër). Së fundmi, problemi i adresuar nga ligji vendas sipas vendimeve të gjykatave nuk ishte i njëjti me problematikën në çështjen në fjalë.

63. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vendos të rrëzojë këtë kundërshtim.

d) Konkluzion

64. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është e pabazuar në fakte sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Më tej, ajo vëren se ajo nuk është e papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Për këtë arsye, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Cilësitë

a) Parashtrimet e palëve

65. Qeveria pohon se afati kohor i ndalimit të ankuesit "gjatë procesit gjyqësor" filloi më 11 qershor 2009, kur dosja e çështjes u transferua në Gjykatën e Rrethit. Sipas tyre, kjo gjë mbështetej nga fakti se ankuesi e paraqiti ankesën për lirimin e tij një vit më vonë, që do të thotë më 19 korrik 2010. Periudha e pezullimit të afatit kohor, i cili është 216 ditë, duhej të zbritej nga periudha e ndalimit "gjatë procesit gjyqësor". Për pasojë, afati kohor përfundoi më 7 shkurt 2011, datë në të cilën Gjykata e Rrethit pranoi kërkesën e ankuesit, që kishte të bënte me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 2 shkurt 2011 të dhënë për një tjetër bashkëtëpandehur. Në çdo rast, afati kohor trevjeçar për kohëzgjatjen e ndalimit përpara gjykimit nuk ishte kaluar.

66. Gjykata parashtroi se në lidhje me kërkesat për lirim, gjykatat më të larta e shqyrtuan çështjen bazuar në dokumentet e marra në konsideratë nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk mund të vlerësonte nëse afatet kohore në vijim të vendimit të asaj gjykate kishin përfunduar. Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë nuk mund të shqyrtonin cilësitë e kërkesës së ankuesit për lirim. I mbetej ankuesit të vendoste nëse donte të bënte një kërkesë të re për lirim, në çdo moment, përpara Gjykatës së Rrethit. Ai e shfrytëzoi këtë mundësi më 6 dhjetor dhe 7 shkurt 2011. Në datën e dytë, Gjykata e Rrethit pranoi kërkesën e tij.

67. Ankuesi parashtroi se qeveria keqinterpretoi vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 3 nëntor 2010

në lidhje me datën e fillimit të periudhës së ndalimit "gjatë gjykimit". Sipas tij, ndalimi i tij "gjatë procesit gjyqësor" filloi më 13 mars 2009 dhe përfundoi më 20 korrik 2010, ose ndryshe, më 14 gusht 2010 ose 7 tetor 2010. Arresti në shtëpi i ankuesit, sipas urdhrit të vendimit në datën 7 shkurt 2011, nuk bazohej në ndonjë parashikim ligjor. Ndalimi i paligjshëm vazhdoi deri më 13 shkurt 2013, kur Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi dënimin e tij.

b) Vlerësimi i Gjykatës

68. Gjykata vëren se ankuesi nuk diskuton ligjshmërinë e arrestimit të tij në datën 17 mars 2008. Gjithashtu, ai nuk ankohet as për kohëzgjatjen e përgjithshme të ndalimit përpara procesit gjyqësor, e cila është një çështje që do të duhej të shqyrtohej në përputhje me nenin 5 § 3 të Konventës. Gjykata vlerëson se thelbi i ankesës ka të bëjë me faktin nëse periudha e ndalimit "gjatë procesit gjyqësor" kishte përfunduar dhe, në rast se po, nëse ndalimi i tij i vazhdueshëm ishte i ligjshëm. Në këto rrethana, Gjykata vëren se kundërshtia kryesore midis palëve lidhet me datat e fillimit dhe të përfundimit të periudhës së ndalimit "gjatë procesit gjyqësor" me Qeverinë, e cila qëndron në pretendimin se ndalimi i ankuesit "gjatë procesit gjyqësor" filloi më 11 qershor 2009 dhe përfundoi më 7 shkurt 2011, datë në të cilën ai kaloi në arrest shtëpie dhe ne ankuesin që argumenton se periudha e ndalimit "gjatë procesit gjyqësor" filloi më 13 mars 2009 dhe përfundoi më 20 korrik 2010, ose ndryshe, më 14 gusht ose 7 tetor 2010 dhe se në secilën prej atyre datave ndalimi i tij i vazhduar nuk ishte i ligjshëm.

69. Gjykata përsërit se shprehjet "i ligjshëm" dhe "në përputhje me një procedurë të parashikuar nga ligji" në nenin 5 § 1 kryesisht i referohen ligjit vendas dhe pohojnë detyrimin për t'iu përmbajtur rregullave procedurale dhe substanciale. Megjithatë, "ligjshmëria" e ndalimit sipas ligjit vendas nuk është gjithmonë elementi vendimtar. Më tej, Gjykata duhet të kënaqet me faktin se ndalimi gjatë periudhës nën shqyrtim ishte në përputhje me qëllimin e nenit 5 § 1 të Konventës, i cili parandalon që njerëzit të privohen nga liria e tyre në një mënyrë arbitrare (shiko për shembull *Bakhumutskiy kundër Rusisë*, nr. 36932/02, § 109, 25 qershor 2009).

70. Gjykata duhet të sigurohet nëse vetë ligji vendas është konform Konventës, duke përfshirë parimet e përgjithshme të shprehura ose të nënkuptuara në të. Në këtë pikë të fundit, Gjykata thekson se, nëse bëhet fjalë për privimin e lirisë, është e rëndësishme që të përmbushet parimi i përgjithshëm i sigurisë ligjore. Për këtë arsye është thelbësore që kushtet për privimin e lirisë sipas ligjit vendas të përcaktohen qartë dhe që vetë ligji të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë të tillë që të përmbushë standardin e "ligjshmërisë" të parashikuar nga Konventa, një standard i cili kërkon që i gjithë ligji të jetë mjaftueshëm preciz në mënyrë të tillë që të lejojë personin - nëse është e nevojshme me këshillimin e duhur – të parashikojë, deri në shkallën që është e arsyeshme për rrethanat, pasojat të cilat mund t'i shkaktojë një akt i caktuar (shiko *Ječius kundër Lituanisë,* nr. 34578/97, § 56, GJEDNJ 2000 – IX dhe *Baranowski kundër Polonisë*, nr. 28358/95, §§ 50-52, GJEDNJ, 2000-III).

71. Duke iu referuar ligjit vendas, neni 263 § 2 i KPP-së pohon se koha e lejuar për ndalimin "gjatë procesit gjyqësor" është dymbëdhjetë muaj. Ky afat kohor fillon që nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë deri në shpalljen e vendimit të asaj gjykate. Në përputhje me nenin 265 të KPP-së, kohëzgjatja e pezullimit të procedimeve, e cila i atribuohet të pandehurit ose njërit nga të bashkëpandehurve, duhet të zbritet nga ajo periudhë.

72. Në çështjen në fjalë, siç interpretohet nga Gjykata e Lartë, dosja u regjistrua në atë gjykatë më 13 mars 2009 (shiko paragrafët 15, 25 dhe 29-31 më sipër). Periudha e ndalimit "gjatë procesit gjyqësor" pritej të përfundonte për dymbëdhjetë muaj. Periudha e pezullimit të procedimeve, më konkretisht tetë muaj dhe dymbëdhjetë ditë, siç llogaritej nga gjykatat vendase (shiko paragrafin 23 më sipër) duhej t'i shtohej asaj periudhe. Për pasojë, periudha e ndalimit "gjatë procesit gjyqësor" përfundoi më 24 nëntor 2010.

73. Gjykata konstaton se gjykatat vendase të cilat merren me çështjen nuk e ndërprenë vendimin e Gjykatës së Lartë më 3 nëntor 2010 në mënyrë uniforme, për sa ka të bëjë me datën e fillimit të

periudhës së ndalimit "gjatë procesit gjyqësor". Më 24 nëntor dhe 6 dhjetor 2010, Gjykata e Rrethit konstatoi se ndalimi "gjatë procesit gjyqësor" kishte filluar që prej 11 qershorit 2009, ndërsa më 2 shkurt 2011, Gjykata e Rrethit gjykoi se afati kohor filloi që prej 13 marsit 2009. Nga ana e saj, qeveria argumentoi se periudha e ndalimit gjatë procesit gjyqësor kishte filluar që prej 11 qershorit 2009 (shiko paragrafin 61 më sipër).

74. Duke pasur parasysh interpretimin kontradiktor të gjykatave vendase në lidhje me pikënisjen e afatit kohor të ndalimit "gjatë procesit gjyqësor", Gjykata argumenton se privimi i lirisë së ankuesit nuk është trajtuar me masat mbrojtëse të duhura kundër arbitrarizmit (shiko *Shaposhnikov kundër Rusisë,* nr. 8998/05, § 47, 29 korrik 2010; *Ismoilov dhe të Tjerët kundër Rusisë*, nr. 2947/06, §§ 138-39, 24 prill 2008; dhe *Nasrulloyev kundër Rusisë*, nr. 656/06, § 77, 11 tetor 2007). Me qëllim përllogaritjen e kohëzgjatjes së ndalimit "gjatë procesit gjyqësor", legjislacioni shqiptar, më konkretisht neni 263 § 2 i KPP-së nuk ishte i qartë dhe i parashikueshëm në zbatimin e tij dhe dështoi në standardin e "cilësisë së ligjit" të kërkuar në përputhje me Konventën (shiko paragrafin 70 më sipër, si edhe Ječius cituar më sipër, § 59; *Mooren kundër Gjermanisë* [GC], nr. 11364/03, § 76, 9 korrik 2009; dhe *Steel dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar,* 23 shtator 1998, § 54, Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve 1998-VII).

75. Për më tepër, ankuesi mbeti i ndaluar "gjatë procesit gjyqësor" deri më 7 shkurt 2011. Në atë datë, Gjykata e Rrethit urdhëroi arrestin në shtëpi të ankuesit, çka përbënte privimin e mëtejshëm të lirisë sipas parashikimit të nenit 5, si edhe sipas ligjit vendas (shiko *Lavents kundër Letonisë*, nr. 58442/00, § 63, 28 nëntor 2002, dhe *Nikolova kundër Bullgarisë*, (nr. 2), nr. 40896/98, § 60, 30 shtator 2004 . Gjykata vëren se Gjykata e Rrethit nuk dha arsye për vendimin e saj për ta kaluar ankuesin në arrest shtëpie. Gjykata tashmë ka pranuar në një sërë rastesh se mungesa e shkaqeve të dhëna nga autoritetet gjyqësore në vendimet e tyre ku autorizohet ndalimi, nuk është në përputhje me parimin e mbrojtjes nga arbitrarizmi sanksionuar në nenin 5 § 1 (shiko, midis shumë autoriteteve të tjera, *Nakhmanovich kundër Rusisë*, nr. 55669/00, §§ 70-71, 2 mars 2006, dhe *Stašaitis kundër Lituanisë*, nr. 47679/99, § 67, 21 mars 2002). Në çështjen konkrete, ankuesi u mbajt në një gjendje pasigurie për shkak të ndalimit të tij të vazhdueshëm nën arrest shtëpie.

76. Gjykata përfundon se ndalimi i vazhduar i ankuesit nga 24 nëntori 2010 (shiko paragrafin 72 më sipër) deri më 12 mars 2012, datë nga e cila ndalimi i tij u udhëhoq nga neni 5 § 1 (a) si rezultat i dënimit të tij nga Gjykata e Rrethit (shiko, midis të tjerëve, *Piotr Baranowski kundër Polonisë*, nr. 39742/05, § 45, 2 tetor 2007 dhe *Belevitskiy kundër Rusisë* nr. 72967/01, § 99, 1 mars 2007) në këtë mënyrë nuk përmbushte standardin e "ligjshmërisë" të kërkuar bazuar në nenin 5 § 1 të Konventës.

77. Në këtë mënyrë, ka pasur një shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 5 § 4 TË KONVENTËS

78. Bazuar në nenin 5 § 4 të Konventës, ankuesi paraqiti pakënaqësinë se ligjshmëria e ndalimit të tij të vazhduar, që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së tij të parë për lirim, nuk u trajtua me shpejtësi. Neni 5 § 4 i Konventës parashikon si më poshtë:

> 4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.

A. Pranueshmëria

79. Qeveria, bazuar në nenet 268 dhe 269 të KPP-së dhe në vendimet vendase (shiko paragrafin 50 më sipër), argumentoi se ligji vendas parashikon të drejtën për kompensim në rastin kur shkelet neni 5 § 4 i Konventës.

80. Ankuesi nuk bëri komente.

81. Gjykata gjykon se një akt për dëmet në parim mund të përbëjë një mjet kompensimi efektiv për aq kohë sa ky akt mund të konstatojë një shkelje të të drejtave të Konventës dhe mund të ofrojë lehtësimin e duhur, më konkretisht një shpërblim për dëmin jomonetar (shiko *Knebl kundër Republikës Çeke*, nr. 20157/05, § 101, 28 tetor 2010). Në rastin konkret, duke u bazuar në konstatimet e saj në paragrafin 62

më sipër, Gjykata nuk mendon se një akt për dëmet mund të paraqitet sipas nenit 268 § 2 të KPP-së, për shkak se gjykatat vendase nuk zbatuan kërkesën e "shpejtësisë" për shqyrtimin e një akti kundër ligjshmërisë së ndalimit të vazhduar. Në këto rrethana, Gjykata vendosi ta rrëzojë këtë kundërshtim.

82. Duke vënë re se kjo ankesë nuk është e pabazuar në fakte sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës dhe as e papranueshme për shkaqe të tjera, Gjykata duhet ta deklarojë atë të pranueshme.

B. Cilësitë

1. Parashtrimet e palëve

83. Qeveria ia atribuoi vonesën në procedime ankuesit dhe avokatit të tij; shpesh ata mungonin në seancat dëgjimore të gjykatës. Duke paraqitur apelime, ankuesi ishte i ndërgjegjshëm se shqyrtimi i çështjes së tij nga gjykatat e larta kërkonte kohë. Në apelim, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë nuk mund të shqyrtonin cilësitë e kërkesës së ankuesit për lirim. Ato e shqyrtuan çështjen bazuar në dokumentet e marra në konsideratë nga Gjykata e Rrethit dhe nuk mund të vlerësonin nëse afatet kohore kishin përfunduar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit. Çështja ishte e ndërlikuar, sepse ajo ishte kundër 29 të bashkëpaditurve dhe shumë veprime procedurale u ndërmorën për të garantuar drejtimin e procedimeve brenda një afati kohor të arsyeshëm. Këta faktorë çuan në zgjatjen e procedimeve.

84. Ankuesi parashtroi se kishte pasur vonesë në shqyrtimin e kërkesës së tij për lirim. Edhe pse u dhanë pesë vendime vendase brenda një periudhe pesëmujore, gjykatat nuk morën një vendim për ligjshmërinë e ndalimit të tij të vazhduar. Në këtë këndvështrim, gjykatat vendase nuk zbatuan udhëzimet e me anë të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 3 nëntor 2010, pavarësisht kompetencës dhe juridiksionit të tyre për ta bërë këtë gjë. Ankuesi u mbajt "peng" i gjyqësorit, i cili veproi kundër shtetit ligjor.

2. Vlerësimet e Gjykatës

85. Gjykata deklaron se neni 5 § 4, i cili iu garanton personave të arrestuar ose të ndaluar të drejtën për të ndërmarrë procedime për të kundërshtuat ligjshmërinë e ndalimit të tyre, gjithashtu, parashikon të drejtën e tyre, në vijim të institucionit të këtyre procedimeve, në një vendim të shpejtë gjyqësor në lidhje me ligjshmërinë e ndalimit dhe urdhëron ndalimin e tij nëse rezulton i paligjshëm (shiko midis të tjerëve *Gubkin kundër Rusisë*, nr. 36941/02, § 152, 23 prill 2009). Kërkesa për dhënien e një vendimi "me nxitim" është në mënyrë të pamohueshme një garanci e tillë. Në këtë kontekst, Gjykata, gjithashtu, vëren se ka një nevojë të veçantë për një vendim të shpejtë që përcakton ligjshmërinë e ndalimit në çështjet kur një proces gjyqësor është pezull, sepse i pandehuri duhet të përfitojë plotësisht nga parimi i mundësisë për pafajësi (shiko *Iłowiecki kundër Polonisë,* nr. 27504/95, § 76, 4 tetor 2001).

86. Edhe pse neni 5 § 4 nuk i detyron shtetet kontraktuese të ngrenë një nivel të dytë juridiksioni ligjshmërie për ndalimin, një shtet i cili krijon një sistem të tillë në parim duhet t'u ofrojë të ndaluarve të njëjtat garanci në apel, si edhe në shkallën e parë. Në të njëjtën kohë, standardi i "shpejtësisë" është më pak i rreptë kur vjen puna te procedimet përpara gjykatës së apelit (shiko, midis të tjerëve *Savriddin Dzhurayev kundër Rusisë,* nr. 71386/10, § 224, GJEDNJ 2013 (ekstrakte)).

87. Edhe pse numri i ditëve të nevojshme për të drejtuar procedimet përkatëse është dukshëm një element i rëndësishëm, në vetvete nuk është vendimtar për çështjen nëse një vendim është dhënë me shpejtësinë e kërkuar (shiko *Merie kundër Holandës* (vendim), nr. 664/05, 20 shtator 2007). Ajo çka merret në konsideratë është kujdesi i treguar nga autoritetet, vonesat e atribuara ankuesit dhe çdo faktor që shkakton vonesë, gjë për të cilën shteti nuk mund të jetë përgjegjës (shiko *Jablonski kundër Polonisë,* nr. 33492/96, §§ 91-94, 21 dhjetor 2000, dhe G.B kundër Zvicrës, nr. 27426/95, §§ 34-39, 30 nëntor 2000). Çështja, nëse e drejta për një vendim të shpejtuar është respektuar, duhet të përcaktohet nën dritën e rrethanave të secilës çështje (shiko *Mooren,* cituar më sipër, § 106, dhe *Abdulkhakov kundër Rusisë,* nr. 14743/11, § 199, 2 tetor 2012).

88. Duke u kthyer në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se ankuesi paraqiti kërkesën e tij të parë për lirim më 19 korrik 2010. Ndërsa Gjykata është e përgatitur të pranojë se procedimet përpara Gjykatës së Rrethit dhe Gjykatës së Apelit u organizuan në kohë duke marrë në konsideratë edhe argumentin e

Qeverisë për sjelljen e ankuesit, gjithsesi Gjykatës së Lartë iu deshën pothuajse tre muaj të shpallte vendimin e saj të datës 3 nëntor 2010. Gjykata nuk shpjegoi se përse Gjykatës së Lartë iu desh një kohë kaq e gjatë të shqyrtonte apelin e ankuesit. Ankuesi nuk mund të fajësohej se kishte përdorur të drejtën e tij legjitime për të apeluar, e cila në cilindo rast kishte rezultuar e suksesshme.

89. Për më tepër, Gjykata vëren se vonesa të tjera ishin shkaktuar për shkak se gjykatat më të ulëta nuk kishin vepruar në përputhje me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 3 nëntor 2010 (shiko paragrafët 17 dhe 18 më sipër). Gjykatës i vjen keq që Gjykata e Apelit, e cila kishte juridiksion mbi faktet dhe ligjin, nuk realizoi një vlerësim të fakteve dhe një shqyrtim të kërkesës së ankuesit për lirim më 17 dhjetor 2010. Kthimet e vazhdueshme, si edhe mospërputhja me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 3 nëntor 2010, shkaktuan një vonesë të pajustifikueshme në procedime (shiko *Mooren*, cituar më sipër, § 107). Një vonesë e tillë i atribuohet shtetit, përgjegjësia e të cilit është të organizojë sistemin ligjor në mënyrë të tillë që të përmbushet kërkesa "e përshpejtuar" bazuar në nenin 5 § 4 të Konventës (shiko, *mutatis mutandis*, *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, § 59, 7 dhjetor 2010).

90. Për sa i përket sa më sipër, Gjykata vlerëson se ka pasur një shkelje të nenit 5 § 4 të Konventës në lidhje me mosshqyrtimin "e përshpejtuar" nga ana e autoriteteve të kërkesës së parë të ankuesit për lirim më 19 korrik 2010.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVEN-TËS

91. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

A. Dëmi

92. Ankuesi kërkoi 150,000 euro (EUR) për dëmin monetar dhe atë jomonetar. Këtu përfshihej humbja e rrogës që ai do të kishte marrë gjatë punësimit të tij, në rast se do të ishte liruar, si edhe ndjenjën e stresit që kishte kaluar ankuesi dhe anëtarët e familjes së tij për më shumë se një vit.

93. Qeveria parashtroi se ankuesi u dënua me burgim sipas një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Si rezultat, periudha e vuajtur në ndalim përpara procesit gjyqësor u përllogarit si burgim bazuar në ligjin vendas. Mbi këtë bazë, ankuesi nuk mund të kërkonte dëm monetar. Në lidhje me dëmin jomonetar, qeveria parashtroi se ishte e hapur ndaj kërkesës për kompensim të ankuesit në gjykatat vendase për periudhën e pretenduar për ndalim të paligjshëm.

94. Në lidhje me argumentet e Qeverisë, Gjykata vlerëson se kërkesa për shfrytëzim të mjeteve vendase për të përfituar shpërblim bazuar në vendimin e Gjykatës do të zgjaste procedurën e ngritur përpara organeve të Konventës në një mënyrë që pothuajse nuk ecën me idenë e një mbrojtje efikase të të drejtave të njeriut (*Papamichalopoulos dhe të Tjerët kundër Greqisë* (neni 50), 31 tetor 1995, § 40, seritë A nr. 330-B). Për më tepër, fakti se ankuesi përsëri mund të marrë një shpërblim për sa i përket dëmit jomonetar sipas procedimeve vendase ligjore nuk e privon atë nga e drejta e tij për të kërkuar kompensim bazuar në nenin 41 të Konventës. Gjykata mund ta shqyrtojë këtë çështje edhe nëse procedimet vendase të një natyre të ngjashme janë ende pezull; çdo interpretim tjetër i nenit 41 të Konventës do ta bënte këtë parashikim joefikas (shiko *Mikheyev kundër Rusisë*, nr. 77617/01, § 155, 26 janar 2006).

95. Gjykata merr në konsideratë parashtrimin e Qeverisë se periudha e vuajtur në paraburgim përpara procesit gjyqësor u përllogarit si burgim. Ajo nuk dallon ndonjë lidhje rastësore midis shkeljes së konstatuar dhe dëmit monetar të pretenduar; për këtë arsye ajo rrëzon këtë kërkesë (shiko midis të tjerave, *Baranowski kundër Polonisë,* nr. 28358/95, § 81, GJEDNJ 2000-III*,* dhe *Stašaitis kundër Lituanisë,* nr. 47679/99, § 99, 21 mars 2002).

96. Gjykata vëren se ka konstatuar një shkelje të nenit 5 § 1 në lidhje me ndalimin e paligjshëm të ankuesit midis datës 24 nëntor 2010 dhe 12 mars 2012, si edhe një shkelje të nenit 5 § 4 të Konventës. Ankuesi mund të ketë vuajtur njëfarë ankthi dhe stresi për shkak të atyre shkeljeve të të drejtave të tij, të cilat nuk mund të kompensohen me anë të një konstatimi të thjeshtë të shkeljes ose me anë të mundësisë

për të paraqitur një kërkesë për kompensim (shiko paragrafin 94 më sipër). Ajo i akordon ankuesit EUR 15,600 për dëmin jomonetar.

B. Kostot dhe shpenzimet

97. Gjithashtu, ankuesi kërkoi EUR 10,000 për kostot dhe shpenzimet e bëra në Gjykatë. Kjo përbënte një shumë të tërë prej EUR 9,500 në lidhje me tarifën ligjore për përfaqësimin e tij dhe EUR 500 për shpenzimet postare dhe të telekomunikimeve.

98. Qeveria parashtroi se ankuesit nuk dorëzuan faturat e detajuara, siç parashikohet nga autoritetet e taksave, në përputhje me ligjin vendas. Ajo i kundërshtoi kërkesat e ankuesve për kostot dhe shpenzimet si të tepruara dhe të paarsyeshme.

99. Sipas ligjeve të nxjerra nga çështjet e Gjykatës, një ankues ka të drejtën të rimbursohet për kostot dhe shpenzimet vetëm nëse tregohet se ato në fakt janë bërë dhe kanë qenë të nevojshme, dhe kanë qenë të arsyeshme (shiko, për shembull, *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, § 72, 29 shtator 2009). Në këtë pikë, Rregulli 60 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës pohon se ankuesit duhet të bashkëlidhin me kërkesat e tyre për kompensim të drejtë "çdo dokument tjetër mbështetës të lidhur me çështjen", dhe nëse kjo gjë nuk ndodh, Gjykata "mund të kundërshtojë kërkesat plotësisht ose pjesërisht".

100. Gjykata nuk mund të pranojë sugjerimin e Qeverisë se kërkohen fatura të miratuara zyrtarisht nga autoritetet e taksave: nuk ekziston një detyrim i tillë sipas Konventës, nuk i takon kësaj Gjykate të rregullojë marrëdhënien midis një taksapaguesi dhe shtetit.

101. Gjykata nuk ka asnjë arsye të dyshojë nëse shpenzimet e ankuesve kanë ndodhur realisht duke qenë se i përket një kuponi kores-pondues. Në lidhje me faktin nëse këto shuma ishin bërë për një nevojë dhe nëse ishin të arsyeshme, Gjykata konstaton se fatura përmban shuma të mëdha, pa një analizë të detajuar të numrit të orëve të faturuara dhe normën kores-ponduese për çdo orë. Në këtë situatë, Gjykata nuk jep asnjë shpërblim në lidhje me tarifat e avokatit të tij.

C. Kamatëvonesa

102. Gjykata e gjykon të arsyeshme që norma e interesit të kamatëvonesës duhet të bazohet në normën marxhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane, së cilës i duhen shtuar pikë trepërqindëshe.

PËR KËTO ARSYE, NJËZËRI, GJYKATA,

E deklaron ankimin të pranueshëm;

2. *Gjykon* se është bërë një shkelje e nenit 5 § 1 të Konventës në lidhje me ndalimin e ankuesit nga 24 nëntori 2010 deri më 12 mars 2012;

3. *Gjykon* se është bërë një shkelje e nenit 5 § 4 e Konventës;

4. *Gjykon:*

a) Se shteti përgjegjës duhet t'i paguajë ankuesit brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi bëhet i formës së prerë në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, 15,600 euro (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind euro), plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme në lidhje me dëmin jomonetar, duke i konvertuar në vlerën monetare të shtetit përgjegjës në normën e aplikueshme në datën e shlyerjes;

b) Se që nga përfundimi i tremujorit të përmendur më sipër deri në shlyerje, interesi i thjeshtë duhet të jetë i pagueshëm në shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marxhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së kamatëvonesës plus pikë trepërqindëshe.

50. *Hedh poshtë* pjesën e mbetur të kërkesës së ankuesit për shpërblim të drejtë.

E përgatitur në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 28 prill 2015, në vijim të Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullave të Gjykatës.

Fatoş Aracı	**Päivi Hirvelä**
Zëvendësregjistrues	*President*

Në përputhje me nenin 45 § 2 të Konventës dhe Rregullit 74 § 2 të Rregullores së Gjykatës, opinionet e veçanta të Gjyqtarëve Mahoney dhe Wojtyczek i janë aneksuar këtij vendimi.

P.H.

F.A.

OPINIONI ALTERNATIV I GJYKATËSIT MAHONEY

103 Edhe pse kam votuar me kolegët e mi për të gjitha pikat e pozicioneve operative, kam për të bërë disa vërejtje në dy aspekte të arsyetimit në lidhje me çështjen për mosshfrytëzim të mjeteve kompensuese vendase.

A. Kur detyrohet qeveria përgjegjëse të japë shembuj për mjetin kompensues tek i cili është mbështetur, i cili përdoret në praktikë?

104. Si gjykatësi Wojtyczek, edhe unë do të kisha preferuar që paragrafi 59 i vendimit në çështjen në fjalë të shpjegojë me më shumë detaje, me anë të një parathënie, pikën e përgjithshme se përse në disa raste qeveria përgjegjëse është e detyruar të japë shembuj të mjetit kompensues të përdorur, i cili në fakt funksionon në praktikë në lidhje me llojin e ankesës së ngritur nga ankuesi, e ndërsa në raste të tjera një gjë e tillë nuk kërkohet. E ndërsa paragrafi 59 i vendimit menjëherë shkon për shqyrtimin e qëllimit të mjetit kompensues kushtetues të kërkuar nga qeveria përgjegjëse shqiptare për çështjen në fjalë, i mbetet lexuesit të nxjerrë për veten e tij ose të saj parimet e para-shtruara që janë në zbatim.

105. Për sa ka të bëjë me këto parime, unë mund të mbështetem në analizën e bërë nga gjykatësi Wojtyczek në paragrafin 2 të opinionit të tij pajtues: në rastin kur mjeti kompensues i kërkuar nga qeveria përgjegjëse ka qartazi mundësi të mbulojë situatën faktike për të cilën është bërë ankesë nga ankuesi dhe të ofrojë kompensimin e duhur, qeveria nuk është e detyruar të japë një listë me shembuj ku mjeti kompensues është përdorur në mënyrë të suksesshme në lidhje me një situatë të tillë faktike. Ky nuk ishte rasti i çështjes në fjalë, gjithsesi, duke qenë se neni 131 (f) i Kushtetutës së Shqipërisë e kufizonte mjetin kompensues të disponueshëm ndaj shkeljes të së drejtës për një - proces gjyqësor të drejtë dhe nuk shkonte më tej, tek ankesa në lidhje me privimin e lirisë (e drejta për liri). Për këtë arsye, qeveria shqiptare duhej të sillte të dhëna për efikasitetin e mjetit kompensues të referuar në lidhje me ankesën specifike të ngritur nga ankuesi (privimi i lirisë); dhe ndërsa ajo nuk e bëri një gjë të tillë, doli detyrimi për të konkluduar se ajo nuk kishte kuptuar ekzistencën e një mjeti kompensues të disponueshëm për të adresuar pakënaqësinë e ankuesit.

B. Detyrimi mbi një ankues, sipas rregullit për shfrytëzimin e mjeteve kompensuese vendase, për të bërë një kërkesë për kompen-sim për privimin e pajustifikuar të lirisë

106. Unë konstatoj se arsyetimi i dhënë në paragrafin është i mjaftueshëm për të rregulluar objektivin paraprak të Qeverisë nën këtë zë: masa për kompensim bazuar në nenin 268 të Kodit të Procedurës Penale për efektshmërinë e tij varet nga ekzistenca e një njohjeje nga gjykatat vendase për një ndalim të paligjshëm, dhe në çështjen konkrete nuk ka ekzistuar një njohje e tillë.

107. Megjithatë, unë do të kisha preferuar që paragrafi i paraprirë, paragrafi 61, të mos mbështetej fare në draftvendimin, sepse sipas meje, arsyetimi i paraqitur atje i nxit në kokë parimin e ndihmës. Unë jam i ndërgjegjshëm se ka njëfarë mbështetjeje nga ligjet e nxjerra gjatë çështjeve të Gjykatës për një arsyetim të tillë, por kjo nuk e bën atë me më pak të meta. Nëse një mjet kompensimi vendas mund të ofrojë të njëjtin kompensim për privimin e pajustifikueshëm të lirisë (një konstatim i paligjshmërisë dhe një shpërblim për kompensim), si edhe ankimi i mëpasshëm në këtë Gjykatë, ky mjet jashtëzakonisht i përshtatshëm vendas duhet të shterohet. Në të kundërt, parimi për mbështetje thjesht injorohet. Dhe, për çfarë arsye?

108. Fakti se ,sipas paragrafit 61 të vendimit, e drejta e dikujt për të mos u privuar nga liria "në përputhje me një procedurë të parashikuar me ligj" nuk është e njëjtë si e drejta për t'u kompensuar, edhe pse është e vërtetë, është disi jashtë çështjes. Neni 5 parashikon disa të drejta të ndryshme në

lidhje me privimin e lirisë përveç së drejtës së pohuar në paragrafin 1. Nëse ligji vendas nuk materializon nën mënyrën e duhur, siç edhe parashikohet në paragrafin 5, të nenit 5, një të drejtë të zbatueshme për kompensim për ndalim të paligjshëm, mund të bëhet një ankesë më veçantë në këtë Gjykatë dhe nën këtë aspekt mund të merret një kompensim i drejtë i veçantë. Megjithatë, nëse sipas ligjit vendas, ekziston një e drejtë e zbatueshme për kompensim për ndalim të paligjshëm në kundërshtim me paragrafin 1, atëherë ekziston një mjet kompensues vendas i cili fillimisht duhet të shfrytëzohet nga një ankues.

109. Po kështu, fakti, i referuar në paragrafin 61 të vendimit, se e drejta procedurale për të pasur ligjshmërinë e ndalimit të shqyrtuar nga një gjykatë është e ndarë nga e drejta për të përvetësuar kompensim për ndalim të paligjshëm, është jashtë diskutimit. Çdo pamundësi nga ana e sistemit ligjor vendas për të siguruar të drejtën për të pasur ligjshmërinë e privimit të lirisë, të shqyrtuar nga një gjykatë, mund të jetë objekt i një ankese të veçantë bazuar në Konventë. Paragrafi 61 i vendimit, në këtë rast mund të duket se ngatërron çështjen e shfrytëzimit të mjeteve kompensuese vendase *ex-post-facto* për ndalimin e paligjshëm me detyrimet e ndara të zbatueshme në vendet kontraktuese nga neni 5 (sipas paragrafëve të tij 3 dhe 4 për të ofruar një sërë masash kompensuese bashkëkohore, parandaluese në lidhje me privimin e lirisë. Unë nuk mund të kuptoj se si logjikisht, ky parashikim i nenit 5 të një sërë të drejtash të procedurale të ndryshme mund të kenë ndonjë incidencë mbi detyrimin e një ankuesi për të ushtruar një mjet kompensues efikas, vendas, pasi ka ndodhur ngjarja për ndalim të paligjshëm – për aq sa qeveria përgjegjëse ia ka dalë të demonstrojë disponue-shmërinë e një mjeti të tillë kompensues, të cilin, sipas paragrafit 62 të vendimit, ajo nuk e bëri në çështjen konkrete.

OPINIONI ALTERNATIV I GJYKATËSIT WOJTYCZEK

1. Në çështjen në fjalë unë jam dakord me rezultatin; megjithatë, nuk jam i bindur me disa pjesë të arsyetimit.

2. Mbrojta efikase e të drejtave të njeriut varet, *inter alia*, nga precizioni dhe qartësia e rregullave që i takon pranueshmërisë së ankesave. Është veçanërisht e rëndësishme të deklarohen rregulla precize për të përcaktuar peshën e provës midis ankuesit dhe Qeverisë përgjegjëse në lidhje me shfrytëzimin e mjeteve kompensuese vendase. Sipas këndvështrimit tim, pjesa e arsyetimit që ka të bëjë me këtë çështje (veçanërisht, paragrafët 59, 61-62, 81) mund të ngrenë dyshime, duke qenë se rregullat e aplikueshme nuk janë përcaktuar qartë. Nuk jam i bindur se lexuesit e vendimit do të kuptojnë plotësisht arsyetimin në qasjen e Gjykatës në këtë drejtim.

Së pari, shumica thekson faktin, se qeveria nuk dha shembuj të ligjeve të nxjerra nga çështjet, të cilat provojnë efikasitetin e mjeteve kompensuese vendase. Megjithatë, nuk është e qartë se në çfarë rrethanash ngrihet një detyrim i tillë për qeveritë përgjegjëse. Në këtë kontekst, ishte e nevojshme dhënia e shpjegimeve mbi këtë pikë. Sipas këndvështrimit tim, qeveritë duhet të ofrojnë shembuj të ligjeve të nxjerra nga çështjet, duke provuar kështu efikasitetin e mjetit kompensues në veçanti, në rastet kur:

1. Mjeti kompensues në fjalë duket se është joefikas (ky është rasti me ankesën kushtetuese në çështjen konkrete); ose

2. Ankuesi ka ofruar shpjegime bindëse se mjeti kompensues nuk do të kishte qenë efikas në rrethanat specifike të çështjes së tij ose të saj.

Së dyti, theksi kryesor se nuk ka vendim vendas që njeh ndalimin e ankuesit ishte i paligjshëm. Megjithatë, ajo që ka lidhje me çështjen nuk ka të bëjë me faktin nëse ka një njohje të tillë ose jo, por nëse ankuesi kishte një mjet kompensues vendas me anë të të cilit të fitonte një njohje të tillë. Mungesa e njohjes nuk është shfajësim nëse ankuesi do të mund të kishte përdorur një mjet kompensues për të siguruar një njohje të tillë.

A ka dalë ligji nga çështjet gjyqësore të Gjykatës dhe a ka përcaktuar rregulla të përgjithshme në lidhje me shfrytëzimin e mjeteve kompensuese vendase, të cilat përmbushin standardet e "udhë-zuesve të duhur kundër arbitrarizmit" dhe "cilësinë e ligjit" të përcaktuar në paragrafin 74 të vendimit?

3. Në lidhje me thelbin, unë jam dakord se ka pasur një shkelje të nenit 5 § 1. Gjykatat vendase përcaktuan se afati kohor për paraburgimin filloi më 13 mars 2009 dhe përfundoi përpara 7 shkurtit 2011 (shiko paragrafët 25–28). Është e qartë se pas afatit kohor të përcaktuar në legjislacionin vendas, ndalimi me paraburgim u bë i paligjshëm.

Shumica konstatoi se legjislacionit shqiptar i mungon qartësia dhe parashikueshmëria (paragrafi 74). Kjo është një deklaratë shumë serioze. Unë nuk jam i bindur me këtë deklaratë. Kjo do të kishte kërkuar një analizë shumë të detajuar të përmbajtjes së ligjit në lidhje me parimet e interpretimit të njohur nga sistemi ligjor shqiptar. Gjithashtu, do të kishte kërkuar një vlerësim të detajuar të ligjeve nga çështjet ligjore dhe të praktikës.

Në këtë kontekst, do të doja të bëja tri vërejtje. Fillimisht, një parashikim ligjor i cili mund të interpretohet në dy ose më shumë mënyra të ndryshme nga gjykatat nuk është automatikisht i papërputhshëm me kërkesat e precizonit, qartësisë dhe parashikueshmërisë. Po kështu, fakti se gjykata të ndryshme kishin pikëpamje të ndryshme në lidhje me inter-pretimin e të njëjtit parashikim të ligjit vendas nuk mund të mjaftojë kurrë *per se* për ta skualifikuar nga këndvështrimi i Konventës.

Së dyti, një person duhet të bëjë dallimin midis situatave tipike dhe atyre jotipike mbi të cilat ushtrohen parashikimet ligjore. Unë vë re se faktet e çështjes në fjalë nuk janë tipike, duke qenë se një nga të bashkëpandehurit ishte Ministër Kabineti, i cili duhej provuar nga Gjykata e Lartë. Vështirësitë interpretative duket se kanë dalë vetëm për shkak të rrethanave të pazakonta të çështjes. Fakti se ligjvënësi nuk mundi të parashikonte të gjitha rrethanat që nuk ishin tipike, sipas së cilave zbatimi i parashikimit ligjor mund të bëhet problematik, nuk e skualifikon *per se* këtë parashikim për mungesë precizioni dhe qartësie.

Së treti, në çështjen konkrete, problemet në lidhje me zbatimin e masës së kundërshtuar u zgjidhën nga gjykatat vendase. Nuk është demon-struar se ka një rrezik real që vështirësi të tilla interpretative do të vazhdojnë edhe në të ardhmen në çështje të ngjashme.

Për ta përmbyllur, në momentin kur zbatohen standardet e precizonit, qartësisë dhe parashikue-shmërisë së legjislacionit, është e nevojshme të merren në konsideratë tiparet e qenësishme të gjuhës ligjore. Më vjen keq që shumica vendosi për standarde të një legjislacioni të mirë, i cili duket se shpërfill mësimet e eksperiencës praktike për shkrimin e masave ligjore.